



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA QEVERIA E KOSOVËS - VLADA KOSOVA - GOVERNMENT OF KOSOVO MINISTRIA E BUJQËSISË, PYLLTARISË DHE ZHVILLIMIT RURAL MINISTARSTVO POLJOPRIVREDE, ŠUMARSTVA I RURALNOG RAZVOJA MINISTRY OF AGRICULTURE, FORESTRY AND RURAL DEVELOPMENT Arkivi Qendror - Centralno Arhivo - Central Archive		
Nr./Br./No.	3306	
Nr i fq. Br. Str. No. pg.	3	
Data./Datum/Data	10.08.2023 PRISHTINE PRISTINA PRISTINA	

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
Ministarstvo Poljoprivrede, Šumarstva i Ruralnog Razvoja
Ministry of Agriculture, Forestry and Rural Development

Kabineti i Ministrit / Kabinet Ministra / Cabinet of the Minister

Datë: 08.08.2023

Ref. KM-269/23

Në mbështetje të nenit 145 (paragrafi 2) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke marrë parasysh nenet 8, 9, 10 dhe 11 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura, (Gazeta Zyrtare, Nr. 7/ 01 mars 2019), duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 1.4) neni 15, Shtojca 11 të Rregullores (QRK)-Nr.02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive (30.03.2021), dhe Nenin 20 (paragrafët 1, 4 dhe 5) të Ligjit Nr. 03/L-042 i Produkteve për Mbrojtjen e Bimëve, (Gazeta Zyrtare Nr. 44, datë 22.12.2008) si dhe në bazë të rekomandimit të Komisionit për vlerësim dhe autorizim të Produkteve për Mbrojtjen e Bimëve, me Ref.04-382/23, të datës 31.07.2023, Ministri i Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, nxjerrë:

VENDIM

Për futjen në regjistër dhe lejimin e autorizimit të produktit për mbrojtjen e bimëve për përdorim

1. Lejohet importimi, vendosja në treg dhe përdorimi i autorizimit të produktit për mbrojtjen e bimëve – Polec i prodhuesit “Sharda Cropchem Limited”, Indi nga përfaqësuesi i saj NTP”Jonatan-P” Prizren.

2. LLOJI I PRODUKTIT: Insekticid

3. PËRMBAJTJA E SUBSTANCËS AKTIVE: Deltamethrin.....25g/l

4. PËRDORIMI:

Nuk është sistemik, por vepron me kontakt dhe ngrënie, prandaj bimët e trajtuara duhet të mbulohen uniformisht me tretësirë.

Ne grurë: për kontrollin e afideve, me 300 ml/ha preparat.

Ne misër: për kontrollin e krimbave të misrit, me 300 ml/ha preparat .

Ne patate: për kontrollin e buburrecit të patates dhe afideve, me 200 ml/ha.

Ne panxhar: për kontrollin e hundëgjatit e pleshtit të panxharit, me 200 ml/ha.

Ne pemëtari: për kontrollin e insekteve brejtës dhe thithës në pemët bërthamorë dhe farore, me 0.03 % (30 ml/100 lit ujë).

Ne vreshtari: për kontrollin e tenjës, hundëgjatit të rrushit, me 0.03 % (30 ml/100 lit ujë). Ne perime: për kontrollin e insekteve thithës në qepe, lulëlakër, lakra jeshile, lakër kokërr, sallate, në domate, bizele, morrit miellor të lakrës, me 0.05 % (50 ml/100 lit ujë).

Ne bimët zbuturuese: për kontrollin e krahëbardhës në bimët e mbjelle në serra, kundër insekteve shpues thithës, në bimët e mbjella në serra dhe fushe, me 0.05 % (50 ml/100 lit ujë). Kundra krimbit të murrme, me 1 litër/ha.

Ne pyje: për kontrollin e afideve të drurëve pyjore, me 0.05 % (50 ml/100 lit ujë). Kryhen maksimumi 2 trajtime/sezon, me interval 14 dite.

5. SASIA E AMBALAZHIMIT PËR IMPORTIM:

40,50,60,75,80,100,125,150,200,250,300,400,500,750,800cc dhe shishe 1,2,3,4,5,10,20L.

6. VËREJTJE:

Mbushni gjysmën e enës së mjetit spërkatës, pastaj shtoni preparatin dhe vini në punë përzierësin dhe pas kësaj hidhni gjysmën tjetër të ujit. Mjeti spërkatës duhet të jetë pajisur me përzierëse, i cili duhet të funksionojë gjatë procesit të punës. Mundësia e përzierjes: Mund të përzieret me shumicën e insekticideve, akaricideve dhe fungicideve

7. KARENCA:

Drithërat 28 dite; patate, domate, peme frutore farore 7 dite; sallate 5 dite; bërthamorë 14 dite.



GHS02-i ndezshëm



GHS05-Paralajmërim për rrezikun-koroz



GHS08- i dëmshëm për shëndetin



GHS07- ngacmues, irritues (cat 2 ose 3



GHS09- paralajmërim (cat 1)-i rrezikshëm

8. PROPOZIMI I KLASIFIKI:

9. VENDI I SHITJËS: Në tërë territorin e Republikës së Kosovës.

10. Produkti për mbrojtjen e bimëve i autorizuar nga pika 1 e këtij vendimi lejohet të importohet në Republikën e Kosovës, deri në afatin siç është përcaktuar në certifikatën e regjistrimit, duke u bazuar në Databazën e Pesticideve të BE-së/Substancave aktive, ndërsa qarkullimi dhe përdorimi i tij lejohet sipas nenit 26 paragrafi 3 i Ligjit Nr.03/L-042 i Produkteve për Mbrojtjen e Bimëve.

11. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.



Faton Peci

Ministër

Vendimi i dërgohet:

- *Komisioni për vlerësimin dhe autorizimin e produkteve për mbrojtjen e bimëve;*
- *Departamenti i Politikave Bujqësore dhe Tregjeve;*
- *Shërbimi kufitar fitosanitar;*
- *Inspektorët fitosanitar AUV;*
- *Importuesit të produkteve për mbrojtjen e bimëve;*
- *Arkivit.*